



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-110

Prishtinë, më 20 maj 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 20 MAJ 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq, Myfera Shinik dhe Goran Marinkoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi;

Nga zyra e Presidentit: Amir Haradinaj,

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Në fillim, kryetari i uroi mirëseardhje kryetarit të Grupit Parlamentar “Ardhmëria e Përbashkët”, z. Goran Marinković.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t’i shtohet edhe një pikë shtesë, ndërsa pika 2.4 të hiqet nga rendi i ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 maj 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave
4. Të ndryshme

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 maj 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 maj 2013.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 23 maj 2013, me këtë

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Zyrës së Rregullatorit për Ujësjiellës dhe Kanalizim për vitin 2012,
5. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2012,
6. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e pyjeve në Kosovë, sipas kërkesës së Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Kërkesa për seancë solemne në nderim të Heroit të Kombit, Rasim Kiçina, dhe shënimit të 24-vjetorit të rënies së Dëshmorit të Kombit, Ali Ajeti, sipas kërkesës së deputetëve Ramiz Lladrovci dhe Latif Gashi, si dhe të deputetëve nënshkrues

Për kërkesën e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit, si dhe kryetarët e grupeve parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, vendosi që Kuvendi të mbajë seancë më 31 maj 2013 në nderim të Heroit të Kombit, Rasim Kiçina, dhe shënimit të 24-vjetorit të rënies së Dëshmorit të Kombit, Ali Ajeti.

Gjithashtu, Kryesia diskutoi edhe për kërkesat e deputetëve për mbajtjen e seancave solemne-përkujtimore dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkesat që parashtrihen në Kryesinë e Kuvendit për mbajtjen e seancave solemne-përkujtimore, mund të procedohen në seancë plenare vetëm me konsensus të anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit dhe të kryetarëve të grupeve parlamentare.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet t'i ushtrojë përgjegjësitë e tij në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Rregulloren e Kuvendit dhe Programin e punës.

2. Kërkesa për debat parlamentar lidhur me rirregullimin (heqjen) e taksave të sigurimeve të automjeteve të udhëtarëve dhe automjeteve transportuese të mallrave, sipas kërkesës së deputetit Ramiz Kelmendi, i mbështetur edhe nga deputetët nënshkrues

Kryesia e shqyrtoi kërkesën e lartpërmendur dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta përgatisë një informatë lidhur me rirregullimin (heqjen) e taksave të sigurimeve të automjeteve të udhëtarëve dhe automjeteve transportuese të mallrave para se Kuvendi të debatojë lidhur me këtë çështje.
2. Informata e kërkuar duhet të përgatitet dhe të procedohet në Kuvend brenda afatit prej dy javësh nga dita e pranimit.

3. Kërkesa për debat parlamentar lidhur me të drejtat elementare të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, sipas kërkesës së deputetit Lutfi Haziri, mbështetur edhe nga deputetët nënshkrues

Kryesia e mbështeti në parim kërkesën e deputetit Lutfi Haziri për mbajtjen e debatit parlamentar të lartshënuar, por data e mbajtjes së debatit do të caktohet në mbledhjen e radhës të Kryesisë.

4. Kërkesa e Grupit të Grave Deputete për alokimin e mjeteve për blerjen e Mamografit mobil

Kryesia e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar dhe nxori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa e Grupit të Grave Deputete për alokimin e mjeteve financiare nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në vlerë prej 30 000 euro për blerjen e Mamografit mobil.

5. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Britani të Madhe

Kryesia e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar dhe nxori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i anëtarëve të Komisionit për Mbikëqyrje e Financave Publike, në këtë përbërje: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci dhe Mursel Halilji, si dhe i stafit mbështetës të Komisionit, Fatime Qorri dhe Mehmet Simnica, për vizitë studimore në Komisionin për Llogari Publike dhe në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Britanisë së Madhe, prej datës 2-5 qershor 2013.

2. Shpenzimet e akomodimit dhe të qëndrimit për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga organizatori, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet shtesë mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

6. Njoftimi i deputetit Hamza Balje për t'iu bashkuar Grupit Parlamentar të SLS-së

Kryesia u njoftua me vendimin e deputetit Hamza Balje se ai prej datës 14 maj 2013 i është bashkangjitur Grupit Parlamentar të SLS-së.

7. Propozimi i GP të SLS-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Për propozimin e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Xhavit Haliti dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit, si dhe kryetarët e grupeve parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Sasha Milosavljeviq dhe Goran Marinković, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të lartshënuara, Kryesia konstatoi se duhen bërë konsultime shtesë lidhur me kërkesën për zëvendësimin e deputetëve në komisione parlamentare.

Pika shitesë:

1. Kërkesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme lidhur me shënimin e përkujtimit të viktimave të Holokaustit

Për kërkesën e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca, nënkryetarë të Kuvendit, si dhe Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës për vendosjen e pllakës për përkujtimin e viktimave të Holokaustit, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Të shikohet mundësia e vendosjes së pllakës për përkujtimin e viktimave të Holokaustit në hapësirën e varrezave të hebrenjve në Prishtinë.
2. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë pllaka përkujtimore e Holokaustit mund të vendoset në hapësirën ndërmjet Kuvendit të Kosovës dhe të Qeverisë së Kosovës.

Të ndryshme:

1. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për mbajtjen e Lutjeve të Mëngjesit

Për kërkesën e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca, nënkryetarë të Kuvendit; Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve lartshënuar, Kryesia e Kuvendit nxori këtë:

V E N D I M

1. Kryesia e Kuvendit e mbështeti kërkesën për mbulimin e pjesërisht të shpenzimeve, në shumë prej 50, 000 euro, për organizimin e ngjarjeve me rastin e Lutjeve të Mëngjesit në Kosovë, që do të mbahen nga data 20 deri më 26 maj 2013.

2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bashkërendim me Komisionin për Buxhet dhe Financa të sigurojë mjetet financiare të cekura në pikën një (1) të këtij vendimi.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale